REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat
Zyra Përmbarimore Private "Ardael" shpk

**Nr.374 Prot. 2401 Regj.** **Tiranë, dt.29.01.2021**

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT Nr. 1167 Prot. Datë 3.2.2021

***URDHER***
***"PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"***

**Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.**

**Për dijeni: Debitorit : Shoqeria « Star » shpk me Nuis K53007401T**
**me administrator Z.Astrit Hoxha**
**Tel :0686078006**
*Adresa :1.Me seli ne Fier , Lagjis Apolonia, pallat 9-katesh.*

**Për dijeni : Kreditorit : Albtelecom sh.a**
*Adresa : Autostraden Tirane-Durres, km 7, Kashar, Tiranë.*

Unë Ardian Elezi, Përmbarues Gjyqësor Privat, përfaqesues i Zyrës Përmbarimore Private "Ardael" shpk, pasi u njoha me materialet e dosjes permbarimore me palë kreditore **Albtelecom sh.a**, dhe palë debitore **Shoqeria « Star » shpk me Nuis K53007401T me administrator Z.Astrit Hoxha** me objekt: permbushje detyrimi.

**K O N S T A T O J:**

Në regjistrin e titujve ekzekutivë të Zyrës Përmbarimore Private "Ardael" shpk, me Përmbarues Gjyqësor Privat Ardian Elezi, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar kërkesa për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Vendimi Nr.62-2015-213(81) dt.22.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, per te cilin eshte leshuar Urdheri i ekzekutimit, Vendimi Nr.21235-00963-62-2014(1078/267) dt.22.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Nga ana jone janë kryer veprimet proceduriale te parashikuara nga ligji për ekzekutimin e ketij titulli ekzekutiv. Per shkak se debitori ka shlyer teresisht detyrimin ndaj kreditorit ekzekutimi i titullit duhet te pushohet.

**Për ketë arsye :**
Në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile
**U R D H Ë R O J:**

1.Heqjen e masës së sekuestros konservative ne kapitalin dhe kuotat ne emer te debitorit **Shoqeria « Star » shpk me Nuis K53007401T me administrator Z.Astrit Hoxha** *banues ne Fier.*
2.Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor .
Faleminderit për bashkëpunimin.

**ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE "ARDAEL" sh.p.k**
**PERMBARUES GJYQESOR**
**ARDIAN ELEZI**

Rr. "Xhorxh W Bush", Kulla 1,Kati I,poshte lokal Elizes,perballe Paralamentit Tel. +355 4 2 250 183
Cel. +355 67 20 27 883
Tiranë, Shqipëri E-mail: ardael2004@yahoo.com